

Dhënie pëlqimi për testimin vetjak në shkollë nëpërmjet testit me antigjen PoC

Me anë të kësaj deklaratë jap pëlqimin tim që fëmija im

_____, lindur më

*

të testohet vetë nëpërmjet testit me antigjen PoC.

Gjatë orarit të mësimit të fëmijës tim mund të më kontaktoni në numrin e telefonit që vijon ose në numrin e celularit/hendit (mjafton edhe nëse jepni vetëm një numër)

1. _____

2. _____

Mënyra sesi do të bëhet testi do të shpjegohet dhe do të mbikqyret në shkollë nëpërmjet personelit të shkollës si dhe nga persona të cilët janë emëruar dhe informuar nga shkolla ose janë mjaftueshëm të kualifikuar për shkak të ushtrimit të profesionit të tyre në fushën e mjekësisë. Tek këto të fundit përfshihen veçanërisht mësues ose ndihmëse dhe ndihmës vullnetarë.

Testimi në thelb do të bëhet me dëshirë - kjo do të thotë që fëmija juaj natyrisht nuk do të detyrohet ta bëjë testin. Por nëse fëmija juaj nuk do të marrë pjesë në test (nuk pranon të testohet) apo nuk ka një përgjigje negative të testit, atëherë nuk do të mund të marrë pjesë në mësim dhe do ti duhet të largohet nga ambientet e shkollës. Më shumë informacion në lidhje me refuzimin e e testit si dhe mundësi të tjera alternative do të gjeni në internet në faqen e Ministrisë për Arsim Shkencë dhe Kulturë në adresën www.schleswig-holstein.de/wirtesten .

Për të testuar fëmijën tuaj do të përdoren vetëm testet që bëhen vetë dhe që janë aprovuar e autorizuar nga Instituti Federal për Medikamente e Produkte mjekësore (BfArM) dhe përdorimi i tyre tek fëmijët dhe të rinjtë nën moshën 18 vjeç nën mbikqyrjen e të rriturve, është i padëmshëm nga ana mjekësore. Testimi i vetvetes bëhet duke marrë sekrecione në pjesën e përparme të hundës nëpërmjet një tamponi.

*Nxënëset dhe nxënësit në moshë madhore nuk kanë nevojë të dorëzojnë deklaratën e dakortësisë (dhënien e pëlqimit). Ata mund ta bëjnë testin pa këtë deklaratë.

Rezultati positive i testit me antigen nuk është një diagnozë e qartë por vetëm një dyshim për një infeksion të mundshëm me koronavirus SARS-Cov-2. Në fakt është e mundshme që pas një testi pozitiv me antigen të dalin rezultate negative nga një test shumë më i saktë si testi PCR-.

Edhe në rastin e një testi negativ paraqitet vetëm një foto e momentit i cili është një hap i rëndësishëm në parandalimin e infeksionit me koronavirus. Testet nuk ofrojnë siguri absolute që fëmija juaj nuk është i infektuar me SARS-Cov-2. Prandaj rregullat e higjenës dhe të distancimit social si dhe kërkesat për mbajtjen e maskave duhet të ndiqen patjetër edhe në rastin e një rezultati negativ.

Dhënia e pëlqimit për vetëtestimin në shkollë nëpërmjet testit me antigen PoC mund të revokohet (kundërshtohet) në çdo kohë në të ardhmen. Pjesëmarrja në vetëtestim presupozon që shkollës i lejohet të informohet mbi rezultatin e testit me antigen PoC.

Testimi do të bëhet sa më herët tëjetë e mundur ditën që paraqiten fëmijët në shkollë. Me dhënien e pëlqimit tuaj për vetëtestimin e fëmijës tuaj në shkollë nëpërmjet testit me antigen PoC jeni të detyruar që në rastin e një rezultati pozitiv të testit të vini dhe të merrni fëmijën tuaj nga shkolla sa më shpejt që është e mundur. Fëmija juaj nuk do të lejohet të përdorë transportin publik.

Nuk këkohet një pëlqim nga ana juaj në përpunimin e mbrojtjes së të dhënave personale pasi baza ligjore për këtë gjë rezulton nga rregulloja e shkollave për koronavirusin sipas ligjit 30 për shkollat. Linkun në lidhje me informacionin për artikullin 13 të rregullores bazë për mbrojtjen e të dhënave si dhe rregulloren e shkollave për koronavirusin e gjeni këtu www.schleswig-holstein.de/DE/Schwerpunkte/Coronavirus/Schulen_Hochschulen/Testen/Rechtliche_Hinweise.html

ose nëpërmjet kodit QR të bashkangjitur

Nëse nuk do të keni mundësi ta merrni këtë informacion online , atëherë drejtojeni ju lutem shkollës së fëmijës tuaj.

Vendi, data

Nënshkrimi I njërit prej kujdestarëve (mundësisht e të dy kujdestarëve *)

*Në parim kërkohet vetëm nënshkrimi I njërit kujdestarëve. Por nëse shkolla është në dijeni të faktit që kujdestarët (prindërit) nuk janë të një mendimi , atëherë do të jenë të nevojshëm nënshkrimet e të dyve.